



SYLLABUS
PROGRAMI MËSIMOR
PUNË DHE POLITIKË SOCIALE

LËNDA: HYRJE NË POLITIKË SOCIALE

VITI AKADEMIK 2022/2023

PROGRAMI STUDIMOR: PUNË DHE POLITIKË SOCIALE

EMRI I LËNDËS: HYRJE NË POLITIKA SOCIALE

FAKULTETI:	FAKULTETI I SHKENCAVE SOCIALE
DEPARTAMENTI:	PUNË DHE POLITIKË SOCIALE
SHIFRA E LËNDËS:	21SS11A020
NIVELI & STATUSI:	6 ECTS Kredi Studime deridiplomike/ VJESHTË 2022 3 orë Ligjërata / 2 orë ushtrime
LIGJËRUESI I LËNDËS:	Elisabeta Ollogu E-mail: elisabeta.bajrami.ollogu@unt.edu.mk
ORËT E KONSULTIMEVE:	Objekti B – “Kongresi i Manastirit”: E Mërkurë, 12.00 - 14.00
ORARI I MËSIMDHËNIES:	Ligjërata: E hënë 09 -12, Klasa B5

WEBMAIL

Si instrument kryesor për komunikim do të shfrytëzojmë Webmail-in. Kontrollimi i email-it është i detyrueshëm.

Googleclassroom

Datat e provimeve dhe informata tjera të rëndësishme mbi fakultetin do të publikohen në (Google-Classroom) Info Teknik - **U22/23 - Hyrje në Politikë Sociale**

KONTURAT E LËNDËS DHE QËLLIMET

Kjo lëndë ka për qëllim që të njohë dhe aftësojë studentët me nocionet kryesore të Politikave Sociale dhe bazat teorike të zhvillimit të politikës sociale si disiplinë akademike. Më konkretisht, lënda ka për qëllim që të njohë studentët me bazën teorike dhe ideologjike të politikës sociale, zhvillimin e saj historik, aktorët që ofrojnë masa nga politika sociale, si dhe njohuri për politikat specifike në fusha si: punësimi, paga, mbrojtja sociale, arsimiti etj.

Kjo lëndë ka disa qëllime kryesore, edhe atë:

- Studentët të kuptojnë dhe sqarojnë konceptet dhe teoritë kryesore të politikave sociale.
- Të kuptojnë shtetin social dhe taksonominë e regjimeve të shtetit social
- Të kuptojnë zhvillimin e politikës sociale në RMV
- Të inicohet mendimi kritik në klasë.
- Të aftësohen studentët që informatat e fituara të shfrytëzojnë për të dhënë vlerësime dhe për të konstruktuar argumente.
- Të zhvillohen aftësitë komunikuese dhe analitike të studentëve.
- Të informohen studentët me procesin politikës sociale dhe të gjitha fazat e politikbërjes sociale dhe në fund të semestrit të jenë në gjendje të shkruajnë një draft-dokument politik nga fusha e mirëqenies sociale.

REZULTATET E NXËNIES

Përshkrimi i i deskriptorëve për rezultatet e nxënies për këtë lëndë:

KATEGORIA	REZULTATET E NXËNIES	METODOLOGJIA VLERËSIMIT	%
Njohuritë dhe të kuptuarit	<ol style="list-style-type: none">1. Të kuptojnë konceptet dhe teoritë kryesore të politikës sociale2. Të kuptojnë historikun dhe zhvillimin e shtetit social në kontinentin Evropian dhe më pas në kontekstin e RMV-së.3. Të arrijnë të analizojnë në mënyrë krahasuese regjimet e shtetit social në Evropë.4. Të arrijnë të kuptojnë dhe analizojnë reformat e	<ol style="list-style-type: none">1. Kolokiumi i parë2. Kolokiumi i dytë	35 35

	<p>realizuara në fushën e politikave sociale në RMV</p> <p>5. Të njihen me aktorët kryesorë, publik dhe jopublik, të cilët kontribuojnë në politikbërjen sociale.</p>		
Zbatimi i njohurive dhe të kuptuarit	<p>Aftësia e studentëve për të përdorur foljet e dobishme (zgjidh, trego, përdor, ilustru, bëj, përfundo, studio, rregullo), gjatë:</p> <p>1. Të kuptuarit të polibërjes sociale si fushë e politikbërjes publike.</p> <p>2. Ilustrimit të zhvillimit të politikave sociale konkrete, në varësi të llojit të regjimit të shtetit social.</p> <p>3. Të krahasuarit e regjimeve të ndryshme të shtetit social në Evropë.</p>	<p>1. Punime bonus</p> <p>2. Aktivitete në klasë</p>	<p>5</p> <p>5</p>
Sjellja gjykimeve	<p>Aftësia e studentëve për të debatuar në klasë mbi terma lidhur direkt me fushën e politikës sociale</p> <p>1. Diturinë - studentët duhet të kenë parasysh konceptet e lidhura me politikën, politikbërjen, institucionet, aktorët publik dhe jopublik, etj.</p> <p>2. Kuptimin - përmes shfaqjes shembujve konkretë të politikave sociale, studentët të arrijnë të shpjegojnë, interpretojnë, përmbledhin, diskutojnë, dallojnë, parashikojnë përsëritin, përshkruajnë një dokument politik;</p> <p>3. Analizimin - studentët përmes krijimit të pyetësorëve të arrijnë tek të dhënat e nevojshme për të analizuar, dalluar, studjuar, krahasuar, shpjeguar fazat e zhvillimit të një dokumenti</p>	<p>1. Ese</p> <p>2. Punim seminarik</p> <p>3. Prezantim</p>	<p>00</p> <p>10</p> <p>5</p>

	<p>politik nga fusha e mirëqenies sociale</p> <p>4. Vlerësimin - përmes përgatitjes së një liste të kriterëve, studentët të arrijnë të vlerësojnë, selektojnë, zgjedhin, vendosin, arsyetojnë, debatojnë, dëshmojnë, argumentojnë, rekomandojnë rreth rezultateve të një dokumenti politik të caktuar.</p>		
Shkathtësitë komunikuese	<p>1. Demonstrim të aftësive komunikuese dhe shkruese, siç janë aftësitë për të shkruar një draft-dokument politik nga fusha e mirëqenies sociale</p>	1. Aktiviteti dhe punë në grupe	5 00 00
Shkathtësitë e të mësuarit	<p>1. Analizë kritike të rasteve të studimit të paraqitura në fund të çdo ligjërate dhe ushtrimit të tyre gjatë orës së ushtrimeve.</p> <p>2. Shfrytëzim efektiv të bibliotekës dhe të dhënave nga interneti në lidhje me politikën sociale dhe shtetin social.</p>	1. Aktiviteti në klasë dhe mendimi kritik i studentëve	5 00 00
Totali			100

PËRSHKRIM PËRMBLEDHËS I VLERËSIMIT

PËRSHKRIMI	%
Prezenca	10
Aktiviteti	5
Detyrat e shtëpisë	?
Detyra tjera	?
Punim seminarik	10
Rast studimi	?
Prezantim	5
Ese	?
Punim laboratorik	?

Projekt	?
Provimi i gjysmë-semesterit	35
Provimi përfundimtarë	35
Totali	100

DETAJE PËR INSTRUMENTET E VLERËSIMIT

METODAT E MËSIMDHËNIES DHE NXËNIES

Lënda Hyrje në Politikë Sociale i ka 6 kredi sipas ECTS sistemit. Mënyra e të mësuarit në lëndën Hyrje në Politikë Sociale do të jetë nga 3 orë ligjërata në javë për 12 javë, me nga 2 orë ushtrime. Dy ditë në javë nga dy orë të plota janë caktuar për konsultime me studentët, ku mund të punohet në mënyrë plotësuese pa kurrfarë kufizimi, studentët mund t'i shfrytëzojnë edhe ditët tjera për konsultime shtesë.

Forma e punës sime në lëndën Hyrje në Politika Sociale është puna frontale (ballore) sepse leksionet i zhvilloj në grupe të mëdha të studentëve. Kjo formë më ndihmon që të t'i iki pasivitetit të studentëve dhe në të njëjtën kohë arrij të nxisë mësim kreativ-problemor duke punuar me tërë klasën.

PROVIMET

Vlerësimi do të realizohet nëpërmes kolokiumit të parë dhe provimit përfundimtar.

Pyetjet mundet të kenë një të njërin nga format vijuese:

- Pyetje të shkurtra mbi konceptet bazike
- Pyetje me zhvillim
- Pyetje argumentuese ku studenti do duhet të mbajë qëndrimin e tij mbi pyetjen argumentuese e cila lidhet një temë që e tangon komplet përmbajtjen e lëndës.

PROJEKTET

Në suaza të kësaj lënde studentët do të jenë të kyçur në realizimin e një punimi seminarik, në përputhje me kriteret në vijim:

1. Punimi seminarik duhet të jetë në grup prej dy studentësh.
2. Tema duhet të jetë direkt e lidhur me lëndën. Në rast të kundërt nuk do të pranohet. Studentët duhet ti referohen syllabus-it të lëndës për tu orientuar mbi zgjedhjen e temës.
3. Fillimisht duhet të aprovet tema e më pas studentët mund të vazhdojnë me realizimin e punimit seminarik.
4. Detyrat e realizuara do të dorëzohen në classroom dhe më pas do të prezantohen.

Për nga aspekti teknik, punimi duhet ti përmbahet kërkesave në vijim:

- Shkrimi: times new roman
- Madhësia: 12
- Format: A4
- Nr. faqeve: poshtë, djathtas
- Punimi duhet të jetë minimumi 8 faqe dhe maksimumi 12 faqe

Studentët kanë për detyrë që punimin seminarik ta prezantojnë në orë të mësimit. Vlerësimi i prezantimit do ti marrë për bazë kriteriumet vijuese:

- Kohëzgjatja
- Aftësia për ta mbajtur vëmendjen e kolegëve

- Shfrytëzimi i mjeteve vizuale
- Teknika tjera të komunikimit
- Përshtypje të përgjithshme

DETYRAT

Në suaza të lëndës Hyrje në Politika Sociale, studentët do të ngarkohen me detyra nga ana e bartësit të lëndës, si dhe gjatë realizimit të ushtrimeve praktike. E gjithë kjo, me qëllim që studentët në mënyrë permanente, njohuritë e përfituara në ligjëratë të munden ti zbatojnë me shembuj të ndryshëm gjatë ushtrimeve me asistentin e lëndës.

PREZENCA DHE RREGULLAT

- Prezenca e studentëve në klasë është e obligueshme. Po qe se shfaqet një situatë për shkak të së cilës ju do të duhet të mungoni (p.sh. për shkak të ndonjë sëmundjeje), ju duhet të na njoftoni sa më shpejt të jetë e mundur. Secili student është I DETYRUAR të ndjekë të paktën 70% të numrit të përgjithshëm të orëve të lëndës (ligjërata dhe ushtrime), për të mundur të hyjë në provimin përfundimtar. Cilido student që nuk i përmbush këto kritere, NUK do të ketë të drejtën të hyjë në provim.
- Të gjithë studentët duhet të blejnë librat e nevojshëm për lëndën nga skriptorja që ju rekomandon profesori i lëndës deri në javën e dytë të ligjëratave. Materialet duhet t'i kenë me vete në çdo orë..

Plagjiatura, etika akademike dhe standardet e sjelljes

Çfarëdo lloji i plagjiaturës nuk do të tolerohet në këtë lëndë. Çfarëdo detyre e dorëzuar nga studenti që është kopjuar (pra, që tenton t'i shfrytëzojë idetë ose argumentet e dikujt tjetër si të vetat), do të marrë zero (0) pikë. Studentët që bëjnë copy/paste nga Interneti nuk do të marrin asnjë pikë (pra, notë zero), pa përjashtim. Profesori i lëndës e mbaj të drejtën që të testoj gojariht studentin për përmbajtjen e detyrës së tij, nëse kam dyshim që projekti/detyrat e tij janë kopjuar ose vjedhur dhe se të njëjtat nuk janë punë origjinale e studentit. Pritet që studentët të sillen në mënyrë profesionale dhe të njerëzishme. Studentët mund t'i diskutojnë detyrat në mënyrë të përgjithshme me të tjerët, mirëpo zgjidhjet duhet të bëhen në mënyrë të pavarur. Puna e notuar duhet të jetë ekskluzivisht e studentit në fjalë.

Kopjimi i punës së tjetërkujt nuk do të tolerohet. Profesorët do të raportojnë pandershmëri akademike dhe çfarëdo forme tjetër të shkeljes së Standardeve të sjelljes te Komiteti për Plagjiaturë pranë fakultetit përkatës.

PËRDORIMI I FACEBOOK-UT/ UEB-IT/ KOMPJUTERËVE/ TELEFONAVE CELULARË

Gjatë tërë kohëzgjatjes së orës mësimore, vëmendja juaj pritët të jetë e përqendruar në mësim dhe detyrat në klasë. Megjithëse jemi të vetëdijshëm se jeni të aftë për të bërë shumë punë përnjëherë, ne kërkojmë që ju megjithatë të përqendrohëni në një gjë gjatë orës mësimore. Duam t'i eliminojmë pengesat gjatë orës mësimore. Në shenjë mirësjelljeje, kërkojmë nga ju të shkyçni telefonat celularë gjatë orëve dhe provimeve.

TABELA E SHKALLËS SË NOTAVE

SHKALLA E NOTAVE	PËRSHKRIMI	NOTA
91% - 100%	Mrekullueshëm	10 (Dhjetë) A
81% - 90%	Shkëlqyeshëm	9 (Nëntë) B
71% - 80%	Shumë mirë	8 (Tetë) C
61% - 70%	Mirë	7 (Shtatë) D
51% - 60%	Mjaftueshëm	6 (Gjashtë) E
0% - 50%	Pamjaftueshëm	5 (Pesë) FX
	E pakryer *	IN
	Pa të dhëna *	NR

BIBLIOGRAFIA

TEKSTET PËR LEXIM (TEKSTET THEMELORE)

TË DETYRUESHME:

Titulli: **Procesi dhe Institucionet e Politikës Sociale**

Autori: Merita Vaso Xhumari

Botuesi: Shtëpia Botuese e Librit Universitar, Tiranë

Viti: 2018, Tiranë

ISBN: 

Titulli: **Социјална политика**

Autori: Ружин Нано

Viti: 2004, Филозофски Факултет

MATERIALE SHITESË

1. Геровска Митев, М. (ур.), Вралување нова социјална политика:актери, димензии и реформи, Филозофски Факултет и Фондација Фридрих Еберт, 2008
2. Балдог, Џ., Менинг, Н. И Векерстаф, С. Социјална политика, Ars Lamina (1000 книги мк), 2013
3. Ревии за социјална политика, Филозофски Факултет и Фондација Фридрих Еберт

/

/

ORARI TENTATIV

JAVA	MODULET	PËRSHKRIMI
JAVË PËR MESIMDHËNIE DHE MESIMNXËNIES		
1	TEKSTET PËR LEXIM	Sillabusi në Classroom
	LIGJËRATAT	Hyrje-njoftim me lëndën, syllabusin, mënyrën e realizimit të ligjëratave, ushtrime dhe të ndryshme.
	USHTRIMET	Njohtim me studentët
	NGARKESA E STUDENTIT	/
2	TEKSTET PËR LEXIM	LEXIMI I OBLIGUESHËM Fq. 9 – 18 Libri “ <i>PROCESI DHE INSTITUCIONET E POLITIKËS SOCIALE</i> ” – Merita (Vaso) Xhumari, 2018 + ligjërata në PPT.
	LIGJËRATAT	NJË KUADËR TEORIK PËR ANALIZËN E POLITIKËS SOCIALE Hyrje në konceptet bazë të politikës Sociale. Qëllimi, objekti dhe karakteri i politikave sociale.
	USHTRIMET	Diskutim i lirë mbi konceptin e politikës
	NGARKESA E STUDENTIT	3+2 orë
3	TEKSTET PËR LEXIM	LEXIMI I OBLIGUESHËM Fq. 41 - 52 Libri “ <i>PROCESI DHE INSTITUCIONET E POLITIKËS SOCIALE</i> ” – Merita (Vaso) Xhumari, 2018 + ligjërata në PPT.
	LIGJËRATAT	SHTETI I MIRËQENIES SOCIALE <i>Historia e SHMS-së</i> <i>Funksionet e shtetit social</i> <i>Ndërhyrja e shtetit në ekonomi</i>
	USHTRIMET	Debat pro dhe kundër ndërhyrjes së shtetit në ekonomi
	NGARKESA E STUDENTIT	3+2 orë
4	TEKSTET PËR LEXIM	LEXIMI I OBLIGUESHËM Fq. 41 - 52 Libri “ <i>PROCESI DHE INSTITUCIONET E POLITIKËS SOCIALE</i> ” – Merita (Vaso) Xhumari, 2018 + ligjërata në PPT.
	LIGJËRATAT	TIPOLOGJITË E SHTETIT SOCIAL. <i>Tipi konservator-korporatist i shtetit social</i> <i>Tipi social demokrat i shtetit social</i> <i>Tipi liberal i shtetit social</i>
	USHTRIMET	Analizë e karakteristikave të shtetit social në RMV
	NGARKESA E STUDENTIT	3+2 orë
5	TEKSTET PËR LEXIM	LEXIMI I OBLIGUESHËM <i>Ligjërata në PPT (skripta)</i>
	LIGJËRATAT	ROLI I IDEOLOGJISË DHE SHTETI SOCIAL. <i>Konservatorizmi dhe rendi social</i> <i>Liberalizmi dhe individualizmi</i> <i>Socialdemokracia dhe universalizmi</i>

	USHTRIMET	Përsëritje e koncepteve bazë
	NGARKESA E STUDENTIT	3+2
6	TEKSTET PËR LEXIM	LEXIMI I OBLIGUESHËM <i>Ligjërata në PPT (skripta)</i>
	LIGJËRATAT	MODELI MIKS I MIRËQENIES SOCIALE <i>Karakteristikat e modelit miks të sigurimit të mirëqenies sociale</i> <i>Financimi i shërbimeve sociale</i> <i>Aktorët e sigurimit të shërbimeve sociale</i>
	USHTRIMET	Studim rasti – Maqedonia vs Shqipëri
	NGARKESA E STUDENTIT	3+2
7	TEKSTET PËR LEXIM	Materialet nga java I deri VII
	LIGJËRATAT	KOLOKUIUM I
	USHTRIMET	/
	NGARKESA E STUDENTIT	1 orë
8	TEKSTET PËR LEXIM	LEXIMI I OBLIGUESHËM <i>Ligjërata në PPT (skripta)</i>
	LIGJËRATAT	SHTETI SOCIAL NË VENDET POST-KOMUNISTE <i>Nga universalizmi tek selektivizmi</i> <i>Terapia e shokut pas rënies së regjimeve</i> <i>Reformat në sistemet e sigurisë sociale</i>
	USHTRIMET	Analizë e reformave në RMV
	NGARKESA E STUDENTIT	3+2 orë
9	TEKSTET PËR LEXIM	LEXIMI I OBLIGUESHËM Fq. 19 – 28 Libri “ <i>PROCESI DHE INSTITUCIONET E POLITIKËS SOCIALE</i> ” – Merita (Vaso) Xhumari, 2018 + ligjërata në PPT. LEXIM PLOTËSUES (jo i obligueshëm) Ligji për Mbrojtje Sociale në Republikën e Maqedonisë
	LIGJËRATAT	MBROJTJA SHOQËRORE Koncepti mbrotje shoqërore Koncepti nevojë sociale Koncepti problem social
	USHTRIMET	Analizë e Ligjit për Mbrojtjen Sociale në RMV
	NGARKESA E STUDENTIT	3+2 orë
10	TEKSTET PËR LEXIM	LEXIMI I OBLIGUESHËM Fq. 30 - 38 Libri “ <i>PROCESI DHE INSTITUCIONET E POLITIKËS SOCIALE</i> ” – Merita (Vaso) Xhumari, 2018 + ligjërata në PPT.
	LIGJËRATAT	INSTITUCIONI I MBROJTJES SHOQËRORE Sigurimet shoqërore sipas modelit Bismarck Modeli Beveridge i mbrotjes shoqërore Institucionet kryesore të mbrotjes shoqërore
	USHTRIMET	Rast studimi: Modeli gjerman I sigurimeve shoqërore
	NGARKESA E STUDENTIT	3+2 orë
11	TEKSTET PËR LEXIM	LEXIMI I OBLIGUESHËM

		<i>Ligjërata në PPT (skripta)</i>
	LIGJËRATAT	REFORMAT NË SISTEMIN E MBROTJES SOCIALE NË RMV <i>Pluralizmi</i> <i>Decentralizimi</i> <i>Deinstitucionalizimi</i>
	USHTRIMET	Përsëritje
	NGARKESA E STUDENTIT	3+2 orë
12	TEKSTET PËR LEXIM	LEXIMI I OBLIGUESHËM <i>Ligjërata në PPT (skripta)</i>
	LIGJËRATAT	NJË MODEL I POLITIKBËRJES SOCIALE <i>Trajektorja e politikës sociale</i> <i>Aktorët dhe institucionet</i>
	USHTRIMET	Shkruani një draft të një politike sociale
	NGARKESA E STUDENTIT	3+2 orë
13	TEKSTET PËR LEXIM	LEXIMI I OBLIGUESHËM Fq. 52 - 155 Libri “ <i>PROCESI DHE INSTITUCIONET E POLITIKËS SOCIALE</i> ” – Merita (Vaso) Xhumari, 2018 + ligjërata në PPT.
	LIGJËRATAT	POLITIKA SOCIALE SI PROCES <i>Nga planifikimi, vlerësimi i nevojave, financimi dhe administrimi e deri tel vlerësimi i rezultateve</i>
	USHTRIMET	Përfundoni së shkruari draftin e politikës sociale
	NGARKESA E STUDENTIT	3+2 orë
JAVË PËR PROVIME DHE MËSIM KLINIK		
7	PROVIMI I GJYSMË-SEMESTRIT TË PARË	Ligjërata deri në javën e shtatë
14	PROVIMI I GJYSMË-SEMESTRIT TË DYTË	Ligjërata nga java VIII deri 13
15	PROVIMI PËRFUNDIMTAR	Provimi përfundimtar

SHËNIM:

Java e provimeve dhe ajo e mësimit klinik mund të ndryshojnë.
